# DËSHMI ARKIVI

**A-445619**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Ma mori emrin dhe ekzistencën time!”/ Britney Spears bën deklaratën tronditëse për të atin |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/15/ma-mori-emrin-dhe-ekzistencen-time-britney-spears-ben-deklaraten-tronditese-per-te-atin/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 10:21:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 10:11:27 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5cf1b92bc2cd6406a546445e98af8d81f24f67e79ba3b084649bd762d042abce` |
| TEKSTI | `6262b4c88011aaff7d7fcf087fcc22188ac51e7f087cf6699695ab5820c8f2f8` |
| PAMJA | `f025d038340fe72516a18cc48180f50f4616474a922832be5c99fa4be2feae94` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `53615dce8b0766bd5ff07f79755ad1ba19efca6e52b333a09eef5bada51b53bb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/53615dce8b0766bd5ff07f79755ad1ba19efca6e52b333a09eef5bada51b53bb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Ma mori emrin dhe ekzistencën time!”/ Britney Spears bën deklaratën tronditëse për të atin

Jetë/stil

Publikuar: 15/09/2026



Britney Spears ka rihapur plagët e së kaluarës dhe ka bërë një deklaratë tronditëse për babain e saj, Jamie Spears. Këngëtarja 44-vjeçare ka rikthyer në vëmendje vitet e kujdestarisë ligjore që i dhanë të atit kontroll mbi financat dhe një pjesë të rëndësishme të jetës së saj.

Deklaratat e forta u bënë në një postim të gjatë në rrjetet sociale, të publikuar në ditëlindjet e dy djemve të saj, Sean Preston dhe Jayden James. Postimi u fshi më vonë, por fjalët e këngëtares ishin shpërndarë tashmë gjerësisht në internet.

Në një pjesë të mesazhit, Spears iu drejtua drejtpërdrejt babait të saj, duke e lidhur gjendjen e tij shëndetësore me vuajtjet që, sipas saj, ka përjetuar gjatë viteve të kujdestarisë.

“Por ju të gjithë më njihni, unë kam falur dhe kam qenë gjithmonë personi më i madh, apo jo. Pyes veten pse Zoti ia mori këmbët babait tim?”, shkroi ajo.

Më tej, këngëtarja vijoi me një tjetër deklaratë të ashpër, duke iu referuar ndjesisë së humbjes së lirisë gjatë periudhës kur ishte nën kujdestari:

“A ma mori emrin dhe ekzistencën time në MURICA, vendi i të lirëve!!”

Britney ka pretenduar gjithashtu se për rreth 15 vjet ka qenë e kufizuar në lëvizjet dhe vendimmarrjen e saj, duke thënë se udhëtimet gjatë asaj periudhe ishin kryesisht të lidhura me punën dhe vendimet e prindërve të saj.

Kujdestaria ligjore nisi në vitin 2008 dhe përfundoi në nëntor të

Me te lexuarat


Bosi i Lufrës hap kartel kompanish dhe fondacionesh. A po pastron në ndërtim paratë e mashtrimit ...


Radikalizohen Flamingot / Alarm të rremë për bomba në shkolla, arrestohet Mandi Jatagani! Ishte e...


“AMG Food” e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë


Një burrë blinte të njëjtin buzëkuq çdo të premte: Punonjësja u përlot kur mësoi historinë


[illegible] IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

vitit 2021, pas më shumë se një dekade. Gjatë kësaj periudhe, Jamie Spears kishte rol në kontrollin e financave dhe aspekteve të tjera të jetës së vajzës së tij.Ndërkohë, Jamie Spears ka përjetuar probleme të rënda shëndetësore. Në vitin 2023, atij iu amputua një këmbë pas një infeksioni serioz, i cili pasoi një ndërhyrje në gju. Sipas raportimeve, ai iu nënshtrua disa operacioneve përpara se amputimi të konsiderohej i nevojshëm.

Megjithatë, mesazhi i Britney-t nuk ishte vetëm për të atin. Këngëtarja po shënonte ditëlindjet e dy djemve të saj: Sean Preston mbushi 21 vjeç, ndërsa Jayden James 20 vjeç.

Në fund të postimit, Spears theksoi edhe ndryshimin që ka përjetuar pas përfundimit të kujdestarisë, duke shprehur mirënjohjen për lirinë që ka sot.

“Sepse tani mund të shkoj kudo që dua. Jam shumë mirënjohëse!”, shkroi ajo.

Edhe pse kujdestaria ka përfunduar prej vitesh, deklaratat e fundit tregojnë se pasojat emocionale të asaj periudhe vazhdojnë të ndikojnë në marrëdhënien e Britney Spears me babain dhe familjen e saj.

TAG: Britney Spears | Dëshmia tronditëse | i ati

## Të ngjashme




**Një burrë blinte të njëjtin buzëkuq çdo të premte: Punonjësja u përlot kur mësoi historinë**




**Beteja ligjore mes Dua Lipës dhe Samsung hyn në një fazë të re, kompania kërkon rrëzimin e padisë prej 15 milionë dollarësh**



**“Di të gatuaj groshë, speca me mazë”, Bebe Rexha tregon në emisionin e famshëm amerikan recetat tradicionale shqiptare**


## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT


klientelistë, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.